



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 151

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E mërkurë, 28 gusht 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 308, datë 26.8.2024	Për emërimin e rektorit të Universitetit të Tiranës..... 18725
Dekret i Presidentit nr. 309, datë 26.8.2024	Për emërimin e rektorit të Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër..... 18725
Dekret i Presidentit nr. 310, datë 26.8.2024	Për emërimin e rektorit të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës.... 18725
Dekret i Presidentit nr. 311, datë 26.8.2024	Për emërimin e rektorit të Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan.. 18725
Dekret i Presidentit nr. 312, datë 26.8.2024	Për emërimin e rektorit të Universitetit të Arteve..... 18726
Dekret i Presidentit nr. 313, datë 26.8.2024	Për emërimin e rektorit të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë..... 18726
Dekret i Presidentit nr. 314, datë 26.8.2024	Për emërimin e rektorit të Universitetit Politeknik të Tiranës..... 18726
Dekret i Presidentit nr. 315, datë 26.8.2024	Për emërimin e rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë..... 18727
Dekret i Presidentit nr. 316, datë 26.8.2024	Për emërimin e rektorit të Universitetit Bujqësor të Tiranës..... 18727
Dekret i Presidentit nr. 317, datë 26.8.2024	Për emërimin e rektorit të Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë..... 18727
Dekret i Presidentit nr. 318, datë 26.8.2024	Për emërimin e rektorit të Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë..... 18728
Dekret i Presidentit nr. 319, datë 26.8.2024	Për emërimin e rektorit të Universitetit të Sporteve të Tiranës..... 18728

Udhëzim i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 1, datë 10.5.2024	Për procedurat e dhënies në përdorim të përkohshëm të territoreve kullota, pjesë e zonave të mbrojtura.....	18728
Urdhër i ministrit të Financave nr. 40/1, datë 19.8.2024	Për përfundimin e delegimit të kompetencës për mbikëqyrjen e veprimtarisë administrative të Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer.....	18734
Urdhër i drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit nr. 44, datë 1.7.2024	Për delegim kompetence.....	18734
Urdhër i ministrit të Financave nr. 116, datë 15.8.2024	Për delegimin e kompetencave.....	18734
Urdhër i ministrit të Financave nr. 119, datë 21.8.2024	Për delegimin e përkohshëm të kompetencës për mbikëqyrjen e veprimtarisë administrative të Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer.....	18735
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 628, datë 16.8.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	18735
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 629, datë 16.8.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Danimarkës.....	18738
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 630, datë 16.8.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Ukrainës.....	18739
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 631, datë 16.8.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Gjermanisë.....	18742
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 632, datë 16.8.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Francës.....	18743
Urdhër i drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës nr. 1420, datë 22.8.2024	Për delegim kompetence.....	18745
Urdhër i drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës nr. 1421, datë 22.8.2024	Për delegim kompetence.....	18745
Vendim i Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 121, datë 30.7.2024	Autorizim i ndihmës shtetërore “Krijimi i një skeme garancie për bizneset inovative për të rinjtë, nëpërmjet mbështetjes financiare me grante”.....	18746

Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 24, datë 20.8.2024	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.....	18748
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 25, datë 20.8.2024	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.....	18749
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 26, datë 20.8.2024	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.....	18750

**DEKRET****Nr. 308, datë 26.8.2024****PËR EMËRIMIN E REKTORIT TË
UNIVERSITETIT TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “g”, nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 39, pika 8, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe mbi bazën e rezultatit të zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese në universitetet publike, përcjellë nga ministri i Arsimit dhe Sportit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Artan Nexhdet Hoxha emërohet rektor i Universitetit të Tiranës.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 309, datë 26.8.2024****PËR EMËRIMIN E REKTORIT TË
UNIVERSITETIT “LUIGJ GURAKUQI”,
SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “g”, nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 39, pika 8, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe mbi bazën e rezultatit të zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese në universitetet publike, përcjellë nga ministri i Arsimit dhe Sportit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Tonin Lukë Gjuraj emërohet rektor i Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 310, datë 26.8.2024****PËR EMËRIMIN E REKTORIT TË
UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR
MOISIU”, DURRËS**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “g”, nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 39, pika 8, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe mbi bazën e rezultatit të zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese në universitetet publike, përcjellë nga ministri i Arsimit dhe Sportit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Shkëlqim Bajram Fortuzi emërohet rektor i Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 311, datë 26.8.2024****PËR EMËRIMIN E REKTORIT TË
UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR
XHUVANI”, ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “g”, nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 39, pika 8, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të



lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe mbi bazën e rezultatit të zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese në universitetet publike, përcjellë nga ministri i Arsimit dhe Sportit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Elvira Yzeir Fetahu emërohet rektor i Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 312, datë 26.8.2024

**PËR EMËRIMIN E REKTORIT TË
UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “g”, nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 39, pika 8, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe mbi bazën e rezultatit të zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese në universitetet publike, përcjellë nga ministri i Arsimit dhe Sportit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Erald Halit Bakalli emërohet rektor i Universitetit të Arteve.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 313, datë 26.8.2024

**PËR EMËRIMIN E REKTORIT TË
UNIVERSITETIT “ISMAIL QEMALI”,
VLORË**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “g”, nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 39, pika 8, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe mbi bazën e rezultatit të zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese në universitetet publike, përcjellë nga ministri i Arsimit dhe Sportit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Aurela Leko Saliaj emërohet rektor i Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 314, datë 26.8.2024

**PËR EMËRIMIN E REKTORIT TË
UNIVERSITETIT POLITEKNIK
TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “g”, nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 39, pika 8, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe mbi bazën e rezultatit të zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese në universitetet publike, përcjellë nga ministri i Arsimit dhe Sportit,



DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Akli Thimaq Fundo emërohet rektor i Universitetit Politeknik të Tiranës.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 315, datë 26.8.2024

**PËR EMËRIMIN E REKTORIT TË
UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË,
TIRANË**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “g”, nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 39, pika 8, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe mbi bazën e rezultatit të zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese në universitetet publike, përcjellë nga ministri i Arsimit dhe Sportit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Xheladin Rexhep Draçini emërohet rektor i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 316, datë 26.8.2024

**PËR EMËRIMIN E REKTORIT TË
UNIVERSITETIT BUJQËSOR
TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “g”, nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 39, pika 8, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe mbi bazën e rezultatit të zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese në universitetet publike, përcjellë nga ministri i Arsimit dhe Sportit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Fatbardh Sefer Sallaku emërohet rektor i Universitetit Bujqësor të Tiranës.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 317, datë 26.8.2024

**PËR EMËRIMIN E REKTORIT TË
UNIVERSITETIT “FAN S. NOLI”,
KORÇË**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “g”, nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 39, pika 8, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe mbi bazën e rezultatit të zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese në universitetet publike, përcjellë nga ministri i Arsimit dhe Sportit,



DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Lorenc Llazaraq Ekonomi emërohet rektor i Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 318, datë 26.8.2024

**PËR EMËRIMIN E REKTORIT TË
UNIVERSITETIT “EQREM ÇABEJ”,
GJIROKASTËR**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “g”, nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 39, pika 8, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe mbi bazën e rezultatit të zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese në universitetet publike, përcjellë nga ministri i Arsimit dhe Sportit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Jaho Jonus Cana emërohet rektor i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 319, datë 26.8.2024

**PËR EMËRIMIN E REKTORIT TË
UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË
TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “g”, nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 39, pika 8, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe mbi bazën e rezultatit të zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese në universitetet publike, përcjellë nga ministri i Arsimit dhe Sportit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Agron Rrahman Kasa emërohet rektor i Universitetit të Sporteve të Tiranës.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

UDHËZIM

Nr. 1, datë 10.5.2024

**PËR PROCEDURAT E DHËNIES NË
PËRDORIM TË PËRKOHSHËM TË
TERRITOREVE KULLOTA, PJESË E
ZONAVE TË MBROJTURA**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe në zbatim të pikës 2/2, të nenit 40, të ligjit nr. 81, datë 4.5.2017, “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Përcaktimin e procedurës për dhënien në përdorim të territoreve kullota, pjesë e zonave të mbrojtura, sipas legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura, ndërmjet AdZM-ve apo ZAPK-ve,



bashkive dhe subjekteve të interesuara, si dhe miratimin e kontratës tip sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe që është pjesë përbërëse e tij.

2. AdZM-ja/ZAPK-ja, brenda datës 15 shkurt të çdo viti, identifikon/përcakton parcelat kullimore publike dhe private për dhënien në përdorim për kullotje, në përputhje me kërkesat teknike të përdorimit të kullotave, sipas legjislacionit në fuqi për kullotat dhe zonat e mbrojtura. Parcelat e ndodhura në kullotat që ndodhen në nënzonën qendrore të zonës së mbrojtur përjashtohen nga përdorimi sipas kërkesave të këtij udhëzimi.

3. Për dhënien me qira të territoreve kullota, mbahet në konsideratë që veprimtaria e kullotjes:

a) të mos cenojë vlerat dhe funksionet natyrore e biologjike të territorit kullor;

b) të jetë në harmoni me elementet e vlerave të biodiversitetit që ka kullota;

c) të kryhet çdo punim mirëmbajtjeje i cili konsiderohet i nevojshëm për ruajtjen e gjendjes natyrore dhe që sjellë përmirësimin e treguesve biologjikë të kullotës;

d) të ruhet mbulesa barishtore nga mbikullotja, duke kontraktuar numrin e bagëtive sipas kapacitetit mbajtës të kullotës;

e) kullotja, pushimi dhe mriimi i bagëtive, të bëhet nga subjekti i interesuar në sistem brezash të alternuar për të mundësuar ruajtjen e gjendjes normale të bimësisë barishtore.

4. Parcelat e identifikuar/propozuara nga AdZM-ja/ZAPK-ja dërgohen për miratim në AKZM dhe miratohen nga drejtori i përgjithshëm.

5. AKZM-ja, brenda datës 1 mars të çdo viti, dërgon në rrugë elektronike dhe shkresore pranë AdZM-së dhe bashkisë përkatëse listën e miratuar të parcelave/nënpelave kullimore, e cila përmban: vendndodhjen, sipërfaqen, llojin e kullotës, kapacitetin kullor të saj dhe infrastrukturën që e shoqëron.

6. AdZM-ja/ZAPK-ja dhe bashkia, menjëherë, shpallin dhe afishojnë listën e miratuar nga AKZM-ja, në faqet zyrtare dhe këndet e njoftimit, me qëllim njoftimin e subjekteve për dhënien me përdorim të parcelave të lejuara.

7. Subjektet e interesuara për lidhjen e kontratave për dhënien në përdorim për kullotje përzgjidhen sipas prioritetit të mëposhtëm:

a) banorët e fshatit dhe/apo ata në afërsi ku ndodhet kullota, pjesë e zonës së mbrojtur;

b) banorët e njësisë administrative ku bën pjesë kullota;

c) banorët që janë brenda territorit të qarkut dhe që shtegtojnë tufat e tyre në njësi administrative të tjera;

d) personat/subjektet e interesuara që tradicionalisht janë shtegtues të tufave të tyre nga njësi administrative/bashki/të tjera.

e) çdo person apo subjekt tjetër i interesuar për përdorimin e territorit kullor.

8. Për marrjen me qira të kullotave publike që janë shpallur në listë, në çdo rast, subjektet e interesuara, të parashikuara në pikën 7, paraqesin kërkesën me shkrim pranë bashkisë:

a) brenda datës 30 mars, për kullotat verore;

b) brenda datës 10 korrik, për kullotat dimërore.

9. Kërkesa përmban:

i. të dhënat e kërkuarit, gjeneralitetet, vendbanimin, adresën e saktë, pikën e kontaktit;

ii. llojin e bagëtive dhe numrin e krerëve që do të kullojnë;

iii. kohën e përdorimit të kullotës, veçanërisht asaj ujëmbajtëse;

iv. vërtetimin nga njësia administrative/bashkia për vendbanimin dhe numrin e bagëtive që kërkuari ka të regjistruar në pronësi;

v. certifikata veterinare që lëshohet nga drejtorja rajonale e bujqësisë;

vi. lista e objekteve që lejohet të ndërtohen në ndihmë të kullotjes, si: stane, kasolle për blegtorët, etj., të tilla sipas rastit.

10. Struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki në bashkëpunim me AdZM-të apo ZAPK-të, shqyrtojnë kërkesat, duke i dhënë prioritet subjekteve sipas parashikimeve të pikës 7 të këtij udhëzimi dhe miratojnë listën e subjekteve të interesuara, brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës.

11. Afati për dhënien në përdorim të kullotave është 5 vjet me të drejtë rinovimi.

12. Vendimi i njoftohet subjekteve të interesuara dhe afishohet në këndet e njoftimit të AdZM-së/ZAPK-së dhe bashkisë.

13. Tarifa për dhënien në përdorim të përkohshëm të territoreve kullota përcaktohen në bazë të vendimit nr. 1156, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e të ardhurave të gjeneruara nga tarifat që paguhet në zonat e mbrojtura, të masës dhe kritereve të



përdorimit të tyre” dhe të ardhurat i kalojnë bashkisë përkatëse.

14. Brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit të miratimit të kërkesës, lidhet kontrata tripalëshe midis AdZM-së/ZAPK-së, bashkisë dhe subjektit të miratuar ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve.

15. Pas nënshkrimit të kontratës, hartohet procesverbali i marrjes në dorëzim të kullotës dhe të objekteve të infrastrukturës që ndodhen në të (lera, çezma etj.), i cili nënshkruhet nga përfaqësuesi i autorizuar i strukturës përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki, AdZM-së/ZAPK-së dhe qiramarrësi. Procesverbali i dorëzimit shoqërohet me hartën e sipërfaqes kullimore.

16. Modeli i kontratës tip tripalëshe gjendet bashkëlidhur në shtojcën 1, të këtij udhëzimi. AdZM-të/ZAPK-të, në varësi të kategorisë së zonës së mbrojtur dhe karakteristikave të saj, mund të përcaktojnë parashikime të tjera si pjesë përbërëse të kontratës.

17. Kontrolli i zbatimit të kërkesave teknike për përdorimin e kullotave të dhëna me qira bëhet nga AKZM-ja dhe trupat inspektuese të AdZM-ve rajonale.

18. Në rast konstatimi të moszbatimit të kushteve të kontratës, AKZM-ja dhe trupat inspektuese të AdZM-ve rajonale, njoftojnë bashkinë për gjetjet e konstatuara, me qëllim vijimin e procedurave për zgjidhjen e kontratës.

19. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, agjencitë rajonale të zonave të mbrojtura/zyra e administrimit të parkut kombëtar, dhe bashkitë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi

KONTRATË QIRAJE
PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË
TERRITORIT KULLOTË NË ZONËN
E MBROJTUR

Sot, më datë [•], në [•], nënshkruhet kjo kontratë qiraje (kontrata), ndërmjet palëve, si më poshtë:

1. AdZM-ja/ZAPK-ja përfaqësuar nga z./znj. [•], në cilësinë e drejtorit të, këtu e në vijim “Qiradhënësi”;

2. Subjekti i interesuar[z./znj.], këtu e në vijim “Qiramarrësi”;

3. Bashkia....., përfaqësuar nga....., si përfitues, këtu e në vijim “Përfituesi”.

Për sa më sipër dhe bazuar në pikën 2/2, të nenit 40, të ligjit nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, palët bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i kontratës

1. Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira e territorit kullotë, pjesë e zonës së mbrojtur, të ndodhur në [•], me sipërfaqe prej [•] m², nën administrimin e AKZM-së, e cila është pjesë e fondit kullor/pyjor të zonës së mbrojtur, ekonomia kullor/pyjor “.....”, nr. parc., me kapacitet krerë, me emrin popullor me këto kufizime dhe koordinata:

Kufizimet

1. Veri:

2. Jug:

3. Lindje:

4. Perëndim:

Koordinatat:

X= Y=

X= Y=

X= Y=

X= Y=

2. Subjektit të interesuar, përveç sipërfaqes së territorit kullotë, sipas pikës 1, të kësaj kontrate, i jepet në përdorim edhe sipërfaqja prej m², për rrugë kalimi/e drejtë kalimi, për të bërë të mundur kalimin nga rruga kryesore për në territorin e marrë në përdorim për të gjithë kohëzgjatjen e kësaj kontrate, nëpërmjet pasurisë së paluajtshme në administrim të qiradhënësit, që nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate.

3. Vendndodhja e territorit kullotë të dhënë në përdorim dhe rruga hyrëse tregohen në hartën bashkëlidhur kësaj kontrate.

Neni 2

Qëllimi i përdorimit

Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia në përdorim e territorit kullotë, pjesë e zonës së mbrojtur, për ushtrimin e aktivitetit të kullotjes, sipas procedurës së parashikuar në udhëzim.

Neni 3
Kohëzgjatja

Kjo kontratë është e vlefshme për 5 vjet, me të drejtë rinovimi.

Neni 4
Vlera vjetore e qirasë

Vlera vjetore e qirasë për përdorimin e territorit kullotë, pjesë e zonës së mbrojtur, llogaritet sipas tarifave të përcaktuara në vendimin nr. 1156, datë _____., të Këshillit të Ministrave.

Konkretisht:

1. Vlera vjetore e qirasë për kullotje, është llogaritur si më poshtë:

Për dhentë krerë ____ x ____ lek/krerë = ____ lek;

Për dhitë krerë ____ x ____ lek/krerë = ____ lek;

Për të trashat krerë ____ x ____ lek/krerë = ____ lek;

Shuma: ____ lek.

2. Vlera vjetore e qirasë për përdorimin e tokës për ndërtim provizore është llogaritur si më poshtë:

Qendër stani e rrethuar, m² ____ x ____ lek = ____ lek;

Qendër punimi bulmeti, m² ____ x ____ lek = ____ lek;

Ngrëhinë banimi për barinj, m² ____ x ____ lek = ____ lek;

Mullinj, magazinë, m² ____ x ____ lek = ____ lek;

Shuma: ____ lek;

Vlera totale e kontratës (gjithsej x 1 vit) ____ lek;

Me shkrim ____ lek.

Neni 5
Pagesa dhe regjistrimi i saj

1. Pagesa e qirasë bëhet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga nënshkrimi i saj nga palët.

2. Vlera e qirasë është e pandryshueshme. Ajo ndryshon vetëm nëse do të ketë ndryshime në VKM-në nr. 1156, datë _____., “_____”.

3. Qiraja paguhet në llogarinë bankare nr. _____, për bashkinë _____, pranë Bankës _____.

4. Në rast se qiramarrësi nuk kryen pagesën sipas kushteve të vendosura sa më sipër, bashkia përfiton një kamatë vonesë prej 0.01% për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se 10 % e vlerës totale të vlerës së pagesës përkatëse. Për efekt të llogaritjes së kamatëvonesave, do të konsiderohet data e përcaktuar në pikën 5.2 të kësaj kontrate.

Neni 6
Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit

1. Qiradhënësi merr përsipër dhe garanton qiramarrësin ndaj pretendimeve nga të tretët për sipërfaqen e territorit të përcaktuar në nenin 1 të kontratës, duke i krijuar qiramarrësit mundësinë që ta përdorë atë për kullotje.

2. Qiradhënësi ushtron kontrolle në çdo kohë, për zbatimin e kushteve të kësaj kontrate nga qiramarrësi dhe nëse konstaton shkelje, mban procesverbal në vend dhe i kërkon qiramarrësit riparimin e dëmeve të konstatuara.

3. Qiradhënësi kryen disa monitorime gjatë periudhës së kullotjes, për të mos lejuar asnjë rast të futjes së bagëtive në kullotë mbi kapacitetin kullor të kontraktuar.

4. Qiradhënësi detyrohet t'i dorëzojë qiramarrësit, menjëherë pas lidhjes së kontratës, hartën me kufijtë e sipërfaqes që do të përdoret për kullotje dhe përdorimin e sipërfaqes së tokës për ndërtimet provizore si stanin, vathën e bagëtive etj., nga fermeri.

5. Qiradhënësi nuk përgjigjet për pretendime të tjera që nuk kanë të bëjnë me objektin dhe qëllimin e kontratës.

6. Qiradhënësi, në rastet kur shfaqen rrethanat si: i. territorit kullotë i del pronari privat që ka vendim të organit shtetëror për kthimin e pronës së paluajtshme; apo ii. territori kullotë i nënshtrohet një përdorimi tjetër me vendim të KKT-së, merr masat të zëvendësojë parcelën e territorit të kullotës, ose në rastet kur nuk ka parcela të lira, të kthejë vlerën e mbetur të qirasë.

7. Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur qiramarrësi nuk ka shlyer vlerën e qirasë, dëmton ose nuk mirëmban territorin e marrë në përdorim.

Neni 7
Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit

1. Me nënshkrimin e kontratës dhe kryerjen e pagesës së qirasë, qiramarrësi merr në dorëzim me procesverbal kullotën, sipas kufijve të hartës, lerat e ujit të pijshëm për blegtorinë dhe objektet e tjera në shërbim të kullotës, nëse ka, dhe në rast dëmtimi të tyre, detyrohet t'i riparojë ato.

2. Pas marrjes në dorëzim të kullotës, qiramarrësi ka të drejtë:



a) të përdorë sipërfaqen e territorit kullotë të marrë në qira për kullotje, për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës;

b) të kryejë çdo veprim të lejueshëm në përputhje me legjislacionin në fuqi për zonat e mbrojtura, i cili mund të konsiderohet i nevojshëm ose i dobishëm gjatë veprimtarisë së kullotjes;

c) të bëjë ndërtime të përkohshme (stane, vathë) për ushtrimin e aktivitetit të kullotjes, në përputhje me planin e menaxhimit të zonës apo rregullave të përcaktuara nga qiradhënësi.

3. Qiramarrësi ka detyrimin:

a) të paraqesë te qiradhënësi dokumentacion të nevojshëm për përmbushjen e kriterëve dhe standardeve minimale për marrjen në përdorim të territoreve kullota;

b) të përdorë territorin, objekt të kësaj kontrate, vetëm për qëllimin e parashikuar në nenin 2, të kësaj kontrate;

c) të plotësojë e të respektojë kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë, të përcaktuara në këtë kontratë;

d) të bashkëpunojë me çdo autoritet publik përgjegjës për monitorimin dhe inspektimin e territoreve kullota, pjesë e zonave të mbrojtura, si dhe t'u japë atyre akses në të gjitha të dhënat/dokumentacionin e nevojshëm për të verifikuar përmbushjen e detyrimeve ligjore përkatëse;

e) të kryejë, me shpenzimet e veta, çdo punim mirëmbajtjeje të cilën e konsideron të nevojshëm, në sipërfaqen e marrë në përdorim dhe në rrugën e kalimit;

f) të dorëzojë bashkëlidhur me mandatpagesën për pagesën e kështit, edhe certifikatën veterinare. Certifikata veterinare i bashkëngjitet kontratës dhe një kopje mbahet në stan për t'u paraqitur autoriteteve të shërbimit veterinar në rast kontrolli;

g) të kryejë, pa shpërblim, zbrazjen e lerës (kur ajo është me saraçineskë), pastrimin e saj dhe të bllokojë rrjedhjet e ujit, për t'u mbushur për sezonin e ardhshëm, në prani të punonjësit të AdZM-së/ZAPK-së _____, ku të mbahet dhe procesverbal për këtë akt;

gj) të marrë të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen e kullotave nga zjarri dhe nëse konstaton rënie të tij, menjëherë duhet të njoftojë dhe të ndërhyjë për shuarjen e tij;

h) të ndajë kullotën në sistem brezash të alternuar, ku të përcaktojë radhën e kullotjes së

tufave në terren me kufij natyrorë të qartë ose me përdorim zhalonësh. Madhësia e brezave të përlllogaritet në raporte të drejta me kapacitetin dhe ditë-kullotjet, në mënyrë të tillë që bagëtia të kullojë në secilën prej tyre jo më shumë se 5–6 ditë. Rikthimi i tufës në brezin e parë të kullotur bëhet pas 15–20 ditësh;

i) të ndërpresë kullotjen e brezit kur lartësia e barit të mbetur pas kullotjes të jetë rreth 4–5 cm;

j) të përcaktojë kohën e fillimit të kullotjes në kontratë, sipas gjendjes konkrete të bimësisë së kullotës;

k) të zbatojë të gjitha rregullat e shërbimit veterinar e shëndetësor dhe të pajiset me to nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë _____;

l) të paguajë vlerën e qirasë sipas parashikimeve të kësaj kontrate.

4. Qiramarrësi nuk ka të drejtë të japë me nënqira territorin kullotë të marrë me qira sipas kontratës.

5. Pas përfundimit të kontratës, qiramarrësi çmonton dhe heq të gjitha ndërtimet provizore dhe e dorëzon territorin e marrë me qira në gjendjen e tij fillestare, përveç konsumimit fizik normal të kullotës dhe ja dorëzon qiradhënësit me procesverbal.

Neni 8

Të drejtat dhe detyrimet e përfituesit

1. Përfituesi ka të drejtë të përfitojë pagesën e qirasë, sipas vlerës së përcaktuar në nenin 4 të kësaj kontrate.

2. Përfituesi, me nënshkrimin e kësaj kontrate, së bashku me qiradhënësin ka detyrimin e hartimit të procesverbalit të marrjes në dorëzim të kullotës dhe të objekteve të infrastrukturës që ndodhen në të (lera, çezma etj.).

3. Përfituesi është i detyruar të mos tjetërsojë objektin e kësaj kontrate, për sa kohë që ajo është në fuqi.

4. Përfituesi është i detyruar të mos ndryshojë qëllimin e kësaj kontrate, për aq kohë sa ajo është në fuqi.

5. Përfituesi është i detyruar të mbajë dokumentacionin origjinal që lidhet me objektin e kësaj kontrate, për aq kohë sa kontrata është në fuqi.

6. Përfituesi është i detyruar të dërgojë informacion/të dhëna nëse kërkohet nga AKZM-ja.



Neni 9

Forca madhore

1. Në rast se ndonjë nga palët e kësaj kontrate pengohet të përmbushë të gjitha ose një pjesë të detyrimeve të saj, të parashikuara në këtë kontratë, si pasojë e forcës madhore, kjo palë nuk do të jetë përgjegjëse: i. për mospërmbushjen e detyrimeve të saj për sa kohë zgjat forca madhore; dhe ii. për pasojat e shkaktuara nga forca madhore.

2. Pezullimi i ekzekutimit të kësaj kontrate, si pasojë e forcës madhore, do të kufizohet në periudhën e kohës gjatë të cilës do të vazhdojnë efektet e forcës madhore.

Neni 10

Zgjidhja e kontratës

1. Kontrata zgjidhet në rastet kur:

a) përfundon afati i përcaktuar në nenin 3, të kontratës;

b) me marrëveshje midis palëve;

c) përpara mbarimit të saj, në rastet kur:

i. janë shkelur dhe nuk janë respektuar kushtet e kontratës;

ii. qiramarrësi dëmton ose nuk mirëmban kullotën, veprat ujëpëruese për blegtorinë (lera, çezma, korita etj.), që ka marrë në përdorim me procesverbal;

iii. konstatohet se qiramarrësi nuk e ka mirëmbajtur kullotën dhe ka dëmtuar elementet e biodiversitetit e treguesit e saj biologjikë;

iv. nuk ka kryer pagesën e vlerës së qirasë sipas kushteve të kontratës;

v. qiramarrësi shkakton zjarre në kullota nga ku, ka dhe detyrimin të paguajë dëmin e shkaktuar.

2. Njoftimi për zgjidhjen e kontratës bëhet me shkrim, 15 ditë përpara zgjidhjes së kontratës.

Neni 11

Dispozitat e fundit

1. Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në kontratë, palët do t'u referohen dispozitave të Kodit Civil dhe udhëzimit në fuqi për dhënien në përdorim të sipërfaqes së kullotës në zonën e mbrojtur.

2. Kontrata përbën marrëveshjen e plotë ndërmjet palëve lidhur me objektin e saj dhe ka

epërsi mbi çdo marrëveshje të mëparshme me gojë apo me shkrim midis palëve.

3. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet palëve, lidhur me kontratën apo ndonjë marrëveshje tjetër, ose dokumenti të nënshkruar nga palët për zbatimin e kontratës, do të zgjidhet nga palët me mirëkuptim; në të kundërt, zgjidhja e mosmarrëveshjes do të jetë në kompetencën e gjykatës administrative përkatëse.

4. Kontrata është hartuar në pesë kopje origjinale, nga të cilat 2 kopje për qiradhënësin, 2 për përfituesin dhe 1 kopje për qiramarrësin, me të njëjtën vlerë secila.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Kontrata hyn në fuqi dhe fillon efektet juridike me nënshkrimin nga palët.

PALET:**QIRADHËNËSI****Administrata****Rajonale e Zonave të****Mbrojtura/ ZAPK-ja****QIRAMARRËSI****Drejtori****PËRFITUESI****Bashkia****Përfaqësuar nga:****Shtojca 1**

Bashkëngjitur harta (skica e vendndodhjes) së sipërfaqes kullimore dhënë në përdorim me kontratë



URDHËR

Nr. 40/1, datë 19.8.2024

**PËR PËRFUNDIMIN E DELEGIMIT TË
KOMPETENCËS PËR MBIKËQYRJEN E
VEPRIMTARISË ADMINISTRATIVE TË
AGJENCISË SË MENAXHIMIT TË
GARANCIVE DHE KREDIVE TË
PAKTHYERA**

Bazuar në pikën 4, të nenit 102, të ligjit 8417/1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si dhe të shkresës së Departamentit të Administratës Publike nr. 4319/2, datë 5.8.2024, me lëndë “Lirim nga pozicioni i rregullt drejtues”,

URDHËROJ:

1. Përfundimin e delegimit të kompetencës për mbikëqyrjen e veprimtarisë administrative të Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer, të znj. Risenaxhaja.

2. Çdo akt që bie në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Drejtoria e Miradministrimit të Aseteve dhe Shërbimeve të Përgjithshme, në Ministrinë e Financave, për komunikimin e këtij urdhri, si dhe znj. Risenaxhaja dhe Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer, për zbatimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE

Petrit Malaj

URDHËR

Nr. 44, datë 1.7.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” dhe udhëzimit nr. 4, datë 29.1.2020, “Për delegimin e të drejtave dhe detyrave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, për nisjen dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit për blerjet me vlera të vogla apo direkte, si dhe nënshkrimin e kontratave për ushtrimin e aktiviteteve të AZHT-së te drejtori i Drejtorisë GIS, z. Endri Bala.

2. Kompetenca e deleguar sipas pikës 1 të këtij urdhri, do të ushtrohet nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri deri më datë 31.12.2024.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri drejtori i Drejtorisë GIS, z. Endri Bala.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Adelajda Roka

URDHËR

Nr. 116, datë 15.8.2024

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 11, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar; të nenit 73, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor të Ministrisë së Financave, sekretarit të përgjithshëm, z. Besmir Beja, për të



gjitha procedurat e prokurimeve publike të parashikuara për t'u realizuar me fondet buxhetore të Ministrisë së Financave.

2. Kompetencat e deleguara do të ushtrohen nga sekretari i përgjithshëm duke filluar nga data 6.8.2024.

3. Urdhri nr. 5, datë 15.1.2024, “Për delegimin e kompetencave” dhe çdo akt tjetër që bie në kundërshtim me këtë urdhër shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCEVE
Petrit Malaj

URDHËR
Nr. 119, datë 21.8.2024

**PËR DELEGIMIN E PËRKOHSHËM TË
KOMPETENCËS PËR MBIKËQYRJEN E
VEPRIMTARISË ADMINISTRATIVE TË
AGJENCISË SË MENAXHIMIT TË
GARANCIVE DHE KREDIVE
TË PAKTHYERA**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të neneve 11, 22 dhe 23, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të germës “d”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000/2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, si dhe të shkresës së Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer me nr. 3792 prot., datë 9.8.2024, “Kërkesë për orientim dhe marrje masash”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e përkohshëm të kompetencës për ushtrimin e mbikëqyrjes së veprimtarisë administrative të Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer (AMGKP), z. Besmir Beja, Sekretar i Përgjithshëm, në Ministrinë e Financave, deri në emërimin e titullarit të AMGKP-së, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Z. Besmir Beja, Sekretar i Përgjithshëm, në Ministrinë e Financave, ngarkohet të ushtrojë të drejtat e zyrtarit përgjegjës për mbikëqyrjen e

Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer (AMGKP), në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi.

3. Delegimi i kompetencës fillon me hyrjen në fuqi të këtij urdhri dhe mbaron me shfuqizimin e tij.

4. Ngarkohet z. Besmir Beja, Sekretar i Përgjithshëm, në Ministrinë e Financave, Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer për zbatimin e këtij urdhri, si dhe Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Ministrinë e Financave, për komunikimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCEVE
Petrit Malaj

URDHËR
Nr. 628, datë 16.8.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E POLONISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre duke përfshirë mishin e vulosur në një kontejner hermetik me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Dolnośląskie*		
Lubelskie*		
Lubuskie*		
Małopolskie*		
Mazowieckie*		
Opolskie*		
Podkarpackie*		



Podlaskie*		
Pomorskie*		
Kujawsko-Pomorskie	Chelmno	Chelmno (rural)*
Warmińsko-Mazurskie*		
Wielkopolskie*		
Zachodniopomorskie*		
Świętokrzyskie*		

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre, mishin e vulosur në një kontejner hermetik me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Polonisë të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë, duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartment (zonë) pa prezencë të murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë, duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

2.2 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinarë, duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10 të Kodit Terrestrial të OIE-së.

2.3 Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë, duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së;



c) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.4 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare, duhet të vërtetohet që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.5 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare, duhet të vërtetohet që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.6 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare, duhet të vërtetohet që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare, duhet të vërtetohet që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartment pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 789, datë 29.12.2023, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Roland Kristo



URDHËR

Nr. 629, datë 16.8.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU TË
SHFAQUR NË SHTETIN E
DANIMARKËS**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve;

b) spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve,

nga shteti i Danimarkës, sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë*	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Veterinary Inspection Unit South	Tønder*	

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 Kodit të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin

e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjithë serotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje, me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjithë serotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinarë të vërtetojë që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupeve ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit), ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit të Kafshëve Tokësore;



d) Certifikata shëndetësore veterinare të vërtetojë që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitruat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8., 4.9 dhe 4.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10, të Kodit të Kafshëve Tokësore.

3. Certifikata veterinare shëndetësore të garantojë origjinën e tyre, sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve të vegjël dhe spermën, dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantëve.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Roland Kristo

URDHËR

Nr. 630, datë 16.8.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E UKRAINËS

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës; nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre, duke përjashtuar mishin e vulosur në një kontejner hermetik me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Chernihiv	Ripkyns'kyi*	
Chernihiv	Chernivets'ka*	
Chernihiv	Nizhyns'kyi*	
Chernihiv	Kozelets'kyi*	
Chernihiv	Pryluts'kyi*	
Chernihiv	Nosivs'kyi	
Chernihiv	Sribnians'kyi*	
Chernihiv	Mens'kyi*	
Chernivtsi	Hlybots'kyi*	
Chernivtsi	Zastavnets'kyi*	
Donets'k	Slovians'kyi*	
Kharkiv	Krasnokuts'kyi*	
Kharkiv	Novovodolaz'kyi*	
Kiev	Obukhivs'kyi*	
Kiev	Vyshhorods'kyi*	
Kiev	Boryspil's'ka*	
Kiev	Ivankivs'kyi*	
Kiev	Holosivs'kyi*	
Kiev	Rokytnians'kyi*	
Kiev	Pereiaslav-Khmel'nyts'kyi*	
Kiev	Bilotserkivs'kyi*	
Kiev	Kaharlyts'kyi*	
Kiev	Tarashchans'kyi*	
Kiev	Myronivs'kyi*	
Kirovohrad	Dobrovelychkivs'kyi*	



Kirovohrad	Kirovohrads'kyi*	
Kirovohrad	Novoukrans'ky*	
Kirovohrad	Svitlovods'kyi*	
Zhytomyr	Zhytomyrs'ka*	
Zhytomyr	Berdychivs'kyi*	
Volyn	Volodymyr-Volyns'kyi*	
Kherson	Beryslavs'kyi*	
Kherson	Novovorontsovs'kyi*	
Mykolayiv	Mykolavs'kyi*	
Mykolayiv	Berezans'kyi*	
Mykolayiv	Berezhnivats'kyi*	
Odessa	Kotovs'kyi*	
Poltava	Kobeliats'kyi*	
Poltava	Kozel'shchyns'kyi*	
Poltava	Poltavs'kyi*	
Sumy	Lebedyns'kyi*	
Sumy	Romens'kyi*	
Vinnitsya	Iampil's'kyi*	

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre, mishin e vulosur në një kontejner hermetik me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Ukrainës, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të pa infektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe

vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Terrestrial të OIE-së.

2.4 Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit.

Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka



dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa

prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 603, datë 5.8.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Ukrainës”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së



Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL**

Roland Kristo

URDHËR

Nr. 631, datë 16.8.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU TË
SHFAQUR NË SHETËTIN E GJERMANISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës; nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve;

b) spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve,

nga shteti i Gjermanisë, sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë*	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Hessen	Vogelsbergkreis	Alsfeld*
Sachsen-Anhalt	Altmarkkreis Salzwedel	Kalbe (Milde)*
Schleswig-Holstein	Nordfriesland	Eiderstedt*
Baden-Württemberg	Rems-Murr-Kreis	Backnang*
Mecklenburg-Vorpommern	Ludwigslust-Parchim	Boizenburg/Elbe*

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 Kodit të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha serotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha serotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinare të vërtetojë që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit



8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitropave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

d) Certifikata shëndetësore veterinare të vërtetojë që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitropat ndaj virusit të gjuhës blu, midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8., 4.9 dhe 4.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose neni 8.3.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore.

3. Certifikata veterinare shëndetësore të garantojë origjinën e tyre sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të

gjalla të llojit të ruminantëve të vegjël dhe spermën, dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Roland Kristo

URDHËR
Nr. 632, datë 16.8.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU TË
SHFAQUR NË SHTETIN E FRANCËS**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, transitimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve;

b) spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantëve dhe kamelidëve.

Nga shteti i Francës, sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë*	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Hauts-de-France	Nord	Avesnes-sur-Helpe*
Hauts-de-France	Aisne	Château-Thierry*
Grand Est	Moselle	Thionville-Est*
Hauts-de-France	Oise	Compiègne*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën



e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit të ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës, dhe;

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjithë serotipave të demonstruar të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjithë serotipeve të demonstruar se janë të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore.

c) Certifikata shëndetësore veterinare të vërtetojë që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes, dhe;

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupeve ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit të Kafshëve Tokësore.

d) Certifikata shëndetësore veterinare të vërtetojë që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes, dhe;

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13, të Kodit të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose neni 8.3.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore.

3. Certifikata veterinare shëndetësore të garantojë origjinën e tyre sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2.

4. Urdhri nr. 618, datë 9.8.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Francës”, shfuqizohet.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e



Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë e të gjithë kafshëve të gjalla të llojit të ruminantë të vegjël dhe spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Roland Kristo**

**URDHËR
Nr. 1420, datë 22.8.2024**

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 28, germa “d”, e ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarisë administrative dhe zbatimit të detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi,

URDHËROJ:

1. Delegimin z. Andi Proko, drejtor i Njesisë së Hartografisë dhe Regjistrit, kompetencën për të sigluar shpërndarjen e korrespondencës shkresore të administruar në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së, sipas fushës përkatëse të përgjegjësisë të njësive/drejtorive/sektorëve.

2. Në rast mungese në detyrë të drejtorit të Njesisë së Hartografisë dhe Regjistrit, delegimi i kompetencës konsiderohet i ndërprerë për periudhën e mungesës në kuptim të nenit 29, pika 2, germa “ç” e Kodit të Procedurave Administrative. Gjatë mungesës, kompetenca ushtrohet nga drejtori i përgjithshëm.

3. Ngarkohet drejtori i Njesisë së Hartografisë dhe Regjistrit dhe Sektori i Arkivës dhe Protokollit

në Drejtorinë e Përgjithshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Lorena Goxhobelli**

**URDHËR
Nr. 1421, datë 22.8.2024**

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të germës “d”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, germës “c”, të pikës 2, të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për Kadastrën”, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarisë administrative dhe zbatimit të detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës z. Enis Hoxha, drejtori i Njesisë së Titujve të Pronësisë për sa vijon:
- Për të nënshkruar shkresat informuese dalëse të Drejtorisë së Përgjithshme, pjesë e fushës së përgjegjësisë së Njesisë së Titujve të Pronësisë, që u drejtohen të tretëve (personave fizikë, personave juridikë, publikë apo privatë), si dhe ato drejtuar strukturave të varësisë të ASHK-së, dhe trajtojnë kërkesë-ankesat që i përkasin korrespondencës shkresore hyrëse të administruar në protokollin e Drejtorisë së Përgjithshme përpara datës 30.7.2024 dhe shpërndarë për ndjekje dhe trajtim nga titullari përpara kësaj date.

- Përfshirë shkresat që i drejtohen Presidentit të Republikës, Kuvendit, Kryeministrit, ministrave, Sekretarit të Përgjithshëm të Kryeministrit/ ministrave, Avokatit të Popullit, Prefektit si dhe kryetarëve të bashkive nënshkruhen nga drejtori i përgjithshëm.

2. Pavarësisht delegimit të kompetencës sipas këtij urdhri, drejtori i Njesisë së Titujve të Pronësisë nëse e gjykon të nevojshme, mund t'i përcjellë për miratim drejtorit të përgjithshmen shkresat që i vlerëson të një rëndësie të veçantë.

3. Delegimi i kompetencës sipas këtij urdhri nuk përfshin aktet administrative dhe detyrat të cilat duhet të miratohen dhe të ushtrohen nga drejtori i



përgjithshëm, në zbatim të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për Kadastrën”.

4. Delegimi i kompetencave sipas përcaktimit të bërë në pikën 1 të këtij urdhri, bëhet për t’u ushtruar nga drejtori i Njesisë së Titujve deri në përmbylljen e procesit të trajtimit dhe përcjelljes së korrespondencës shkresore sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1 të këtij urdhri.

5. Në rast mungese në detyrë të drejtorit të Njesisë së Titujve të Pronësisë, delegimi i kompetencës konsiderohet i ndërprerë për periudhën e mungesës në kuptim të nenit 29, pika 2, germa “c”, të Kodit të Procedurave Administrative. Gjatë mungesës, kompetenca ushtrohet nga drejtori i përgjithshëm.

6. Pas përmbylljes së detyrimeve, sipas përcaktimeve të pikës 4 të këtij urdhri, delegimi i kompetencave quhet i përfunduar.

7. Ngarkohet Njësia e Titujve të Pronësisë dhe drejtori i tyre dhe Sektori i Arkiv-Protokollit në Drejtorinë e Përgjithshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Lorena Goxhobelli

VENDIM
Nr. 121, datë 30.7.2024

**AUTORIZIM I NDIHMËS
SHTETËRORE “KRIJIMI I NJË SKEME
GARANCIE PËR BIZNESET
INOVATIVE PËR TË RINJTË,
NËPËRMJET MBËSHTETJES
FINANCIARE ME GRANTE”**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

- Z. Blendi Gonxhja kryetar;
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtare;
- Znj. Brikena Qela anëtare;
- Znj. Keida Qirko anëtare;
- Z. Ahmet Mançellari anëtar,

Në mbledhjen e tij të radhës të datës 30.7.2024, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores ‘Për procedurat dhe formën e njoftimit’” shqyrtoi njoftimin e Bashkisë Shkodër lidhur me planin e dhënies së ndihmës shtetërore për

projektin “Krijimi i një skeme garancie për bizneset inovative për të rinjtë, nëpërmjet mbështetjes financiare me grante”.

I. Procedura

1. Bashkia Shkodër me shkresën nr. 14670, datë 11.7.2024, në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, njoftoi në Komisionin e Ndihmës Shtetërore planin e ndihmës shtetërore të sipërpërmendur, në bazë të vendimit të Këshillit Bashkiak Shkodër nr. 55, datë 29.12.2023, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024–2026 të Bashkisë Shkodër” dhe vendimit të kryetarit të Bashkisë Shkodër nr. 398, datë 24.4.2024, “Për miratimin e rialokimit të fondit të shpenzimeve korrente brenda të njëjtit program pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale/Sektori i Rinisë për vitin 2024”.

II. Përshkrimi i masës

2. *Objekti:* plani i ndihmës ka si objektiv promovimin e modelit të qëndrueshëm të zhvillimit ekonomik, miqësor ndaj mjedisit, për t’u dhënë proceseve, produkteve dhe shërbimeve të NMMV-ve një vlerë të shtuar në treg. Planin synon ndërtimin e kapaciteteve të të rinjve me aftësitë e nevojshme për një ekonomi të gjelbër.

3. *Baza ligjore e njoftimit të planit:* plani i ndihmës shtetërore është miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Shkodër nr. 55, datë 29.12.2023, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024–2026 të Bashkisë Shkodër” dhe vendimit të kryetarit të Bashkisë Shkodër nr. 398, datë 24.4.2024, “Për miratimin e rialokimit të fondit të shpenzimeve korrente brenda të njëjtit program pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale/Sektori i Rinisë për vitin 2024”.

4. *Kohëzgjatja:* plani i ndihmës do të zbatohet në periudhën 2024–2025.

5. *Dhënësi i ndihmës* dhe autoriteti përgjegjës për zbatimin e masës është Bashkia e Shkodër.

6. *Përfituesit:* përfitues janë shtetasit shqiptar të moshës 18–30 vjeç, banues në Bashkinë Shkodër, të cilët kanë një ide apo kanë një biznes ekzistues të vogël ose të mesëm dhe kërkojnë të shndërrohen në biznese ekoinovative. Në rastin kur aplikimi i individëve është shpallur fitues, Bashkia Shkodër do të kërkojë regjistrimin e tij si një entitet ligjor përpara nënshkrimit të kontratës dhe disbursimit të fondeve.

7. *Shtrirja territoriale:* projekti do të zbatohet në territorin e Bashkisë Shkodër.



8. *Forma dhe vlera e ndihmës*: vlera e ndihmës shtetërore është 4.600.000 (katër milionë e gjashtëqind mijë) lekë në formën e grantit të drejtpërdrejtë nga fondet e miratuara për Bashkinë Shkodër. Çdo përfitues do të mbështetet deri në shumën 800.000 (tetëqind mijë) lekë.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

9. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson nëse plani i ndihmës shtetërore për bizneset me fokus ripërdorimin, përbën ndihmë shtetërore në kuptim të paragrafi 1, të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, pra nëse plani ofron një avantazh ekonomik për ndërmarrje, të cilat kanë një ndikim të mundshëm në konkurrencë dhe tregtinë midis shteteve anëtare, që nuk do të ishte përfituar në kushte normale të tregut.

10. Neni 4, pika 1 e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, përcakton se:

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdoqë formë, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojnë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore”.

11. Gjithashtu, neni 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë¹, përcakton se:

“Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kritereve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87, të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”

12. Ligji i ndihmës shtetërore zbatohet vetëm për masat që plotësojnë të gjitha kriteret e përmendura në nenin 4, pika 1, konkretisht: a) burime shtetërore; b) avantazhi ekonomik; c) përzgjedhja; dhe d) efekti në konkurrencë dhe treg.

13. Plan i njoftuar nga Bashkia Shkodër do të financohet nga burime shtetërore, respektivisht buxheti i Bashkisë Shkodër. Plan i ndihmës jep një

avantazh për përfituesit në formën e mbështetjes financiare me grante. Në këto kushte, plani i ndihmës jep një avantazh për ata përfitues, të cilët nuk do të mund ta kishin përfituar mbështetjen me grante në kushte normale të tregut. Përfituesit do të përdorin ndihmën për mirëmbajtjen e ekosistemeve të shëndetshme, minimizimin e ndotjes dhe mbeturinave, kufizimin e emetimeve të serrës dhe ofrimin e mallrave dhe shërbimeve të gjelbra për të mundësuar modele më të përgjegjshme të konsumit. Avantazhi i dhënë është përzgjedhës, sepse do të akordohet vetëm për ndërmarrjet e përzgjedhura sipas paragrafi 6. Plan i njoftuar i ndihmës ka potencial për të ndikuar në konkurrencë dhe në tregti, duke përmirësuar pozicionin konkurrues të përfituesve të skemës.

Në këto kushte, Komisioni vlerëson se plani i njoftuar është ndihmë shtetërore, e cila është e ndaluar, përveç rasteve të parashikuara ndryshe në ligjin nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

14. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson skemën e njoftuar në përputhje me nenin 8, të ligjit 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, i cili parashikon:

“Ndihma “De minimis” është e lejueshme nëse, pavarësisht nga forma ose qëllimi për të cilin i jepet një ndërmarrjeje, nuk kalon vlerën maksimale për një aktivitet të caktuar, për një periudhë financiare prej tre vjetësh.”

Mbështetur në kreun II, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 605, datë 31.8.2016, “Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës “De minimis”, vlera maksimale e lejuar e ndihmës, si dhe kushtet për autorizimin e ndihmës përcaktohet si vijon:

1. Ndihma lejohet nëse përmbushen, njëherësh, të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje të vetme nuk i kalon 14.000.000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh, e llogaritur në përputhje me kushtet dhe parimet e parashtruara në kreun 3 të këtij vendimi;

b) ndihma është transparente, nëse ekuivalenti bruto i grantit (EBG) mund të llogaritet me saktësi para dhënies së ndihmës, pa pasur nevojë të kryhet një vlerësim risku për

¹ Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së stabilizim-asociimit ndërmjet Republikës

së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtare”.



konkurrencën, në përputhje me kërkesat dhe parimet e parashtruara në kreun 4 të këtij vendimi.

Në kreun III “Llogaritja e ekuivalentit bruto të grantit”, të VKM-së nr. 605, datë 31.8.2016, përcaktohet se: “1 .Granti dhe subvencioni në të holla janë ndihmë transparente”.

Sa më sipër, bazuar në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, dhe VKM-së nr. 605/2016, ndihma “*De minimis*” lejohet, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje nuk i kalon 14.000.000 (*katërmëdhjetë milionë*) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh. Ky kusht plotësohet duke qenë se ndihma shtetërore për një ndërmarrje është në vlerën deri në 800.000 (tetëqind mijë) lekë;

b) ndihma duhet të jepet për një periudhë financiare prej tre vjetësh. Kohëzgjatja e skemës, e cila është marrë në shqyrtim është më pak se tre vjet, duke plotësuar këtë kusht ligjor;

c) ndihma është transparente. Në rastin konkret, ndihma jepet në formën e grantit.

Sa më lart, Komisioni vlerëson se plani i ndihmës shtetërore është i lejueshëm në përputhje me nenin 8, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 8, 22, dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë skemën e ndihmës shtetërore “Krijimi i një skeme garancie për bizneset inovative për të rinjtë, nëpërmjet mbështetjes financiare me grante”, të miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Shkodër nr. 55, datë 29.12.2023, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024–2026 të Bashkisë Shkodër” dhe vendimit të kryetarit të Bashkisë Shkodër nr. 398, datë 24.4.2024, “Për miratimin e rialokimit të fondit të shpenzimeve korrente brenda të njëjtit program pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale/Sektori i Rinisë për vitin 2024”.

2. Çdo përfitues ndihme duhet të nënshkruajë deklaratën e ndihmës “*De-minimis*” dhe të dorëzojë një kopje të deklaratës pranë Bashkisë Shkodër.

3. Bashkia Shkodër brenda datës 31 mars të çdo viti të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Raportet e zbatimit duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet e bëra dhe produktet e arritura.

4. Të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

5. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONI I NDIHMËS SHTETËRORE

Kryetar: Blendi Gonxhja

Anëtarë: Mimoza Dhëmbi, Brikena Qela, Keida Qirko, Ahmet Maçellari

VENDIM

Nr. 24, datë 20.8.2024

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ë ndryshuar; të kreut I, të nenit 22, pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, ë ndryshuar; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, të kryetarit të Autoritetit, “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror” në AIDSSH”, të ndryshuar me urdhrin nr. 56, datë 23.3.2023, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, ‘Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 24 , datë 20.8.2024, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Dibër, dosje pune dhe personale nr. 2366, “Kritiku”, në ngarkim të Xh. M., me 114 (njëqind e katërmëdhjetë) fletë. Dosja daton në



vitet 1974–1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

2. Arkiva e Autoritetit, Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, procesverbal asgjësimi nr. 18, datë 26.5.1982, në ngarkim të L. Ç., me 1 (një) fletë. Dokumenti daton në vitin 1982. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “Sekret”.

3. Arkiva e Autoritetit, Fondi të Arratisur, fashikull nr. 2803, në ngarkim të R. A., me 145 (njëqind e dyzet e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1946–1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

4. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Elbasan, dosje formulare nr. 6502, në ngarkim të B. B., me 3 volume, në total me 780 (shtatëqind e tetëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1961–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

5. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Krujë, dosje agjenturore nr. 1735, “Paraziti” në ngarkim të F. D., me 40 (dyzet) fletë. Dosja daton në vitet 1982–1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

6. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Krujë, dosje formulare nr. 1731, në ngarkim të F. D., me 128 (njëqind e njëzet e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1982–1984. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

7. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Lushnjë, dosje pune nr. 899, “Rozmaria” në ngarkim të E. K., me 184 (njëqind e tetëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1965–1974. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

8. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Ersekë, dosje pune dhe personale nr. 456, “Benzinati” në ngarkim të Z. H., me 282 (dyqind e tetëdhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1958–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

1. Arsyeja e deklasifikimit të dokumenteve të sipërcituara është:

· Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenin 22, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, si dhe në vendimin e Autoritetit nr. 31, datë 24.1.2023, pika 1 e dispozitivit.

2. Ngarkohet Sekretari i KDZH-së të bëjë evidentimet përkatëse në regjistrë, të vendosë vulën

përkatëse mbi dokumentet e deklasifikuara dhe të hartojë bibliografinë e informacionit të deklasifikuar.

3. Kopja e bibliografisë së informacionit të deklasifikuar t’i dërgohet zyrtarisht Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

4. Të bëhet publikimi i dokumenteve të deklasifikuara në faqen zyrtare të internetit të AIDSSH-së dhe në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KDZH-së

Gentiana Sula

VENDIM

Nr. 25, datë 20.8.2024

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar; në kreun I, nenit 22, pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, të ndryshuar; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, të kryetarit të Autoritetit, “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, i ndryshuar me urdhrin nr. 56, datë 23.3.2023, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, ‘Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 25, datë 20.8.2024, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Arkiva e Autoritetit, Fondi Ushtria, dosje për objekt të rëndësisë së veçantë nr. 49 , Reparti ushtarak nr. 3205, Vlorë, me 32 (tridhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1970–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

2. Arkiva e Autoritetit, Fondi Ushtria, procesverbale asgjësimi të dokumenteve të repartit



ushtarak 3205 Vlorë, datë, datojnë në vitin 1991, me 22 (njëzetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “Sekret”.

3. Arkiva e Autoritetit, Fondi Ushtria, dosje për objekt të rëndësisë së veçantë nr. 1069, për repartin ushtarak 8795 Orikum, dy volume, me 23 (njëzetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

4. Arkiva e Autoritetit, Fondi Ushtria, Libri i Evidencës të punëtorit operativ të Sigurimit të Ushtrisë, me 100 (një qind) fletë. Dosja daton në 1988-n. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

5. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Durrës, dosje formulare nr. 4638, në ngarkim të Xh. B, me 480 (katërqind e tetëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1958–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

6. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Lushnjë, dosje formulare nr. 1782, në ngarkim të F. K, me 354 (treqind e pesëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1950–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

7. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Dibër, dosje përpunimi nr. 89, në ngarkim të A. A, me 85 (tetëdhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1953–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

8. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Lushnjë, dosje përpunimi nr. 3182, në ngarkim të M. K, me 68 (gjashtëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1984–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

9. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Pukë, dosje formulare nr. 618, në ngarkim të Gj. H, me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1974–1976. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

10. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje përpunimi nr. 397, në ngarkim të S. H, me 113 (njëqind e trembëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1951–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

11. Arkiva e Autoritetit, Fondi Veçantë, Fashikulli Agjenti, “Alfredi” në ngarkim të J. Ll, me 54 (pesëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1953–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

12. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Mat, dosje pune dhe personale nr. 2932, në ngarkim të P. A, me 84 (tetëdhjetë e katër) fletë.

Dosja daton në vitet 1958–1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

13. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Korçë, dosje formulare nr. 289, si dhe dosje hetuesie, në ngarkim të J. Ll, me 461 (katërqind e gjashtëdhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitet 1953–1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

1. Arsyeja e deklasifikimit të dokumenteve të sipërcituara është:

- Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenin 22, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, si dhe në vendimin e Autoritetit nr. 31, datë 24.1.2023, pika 1 e dispozitivit.

2. Ngarkohet Sekretari i KDZH-së të bëjë evidentimet përkatëse në regjistër, të vendosë vulën përkatëse mbi dokumentet e deklasifikuara dhe të hartojë bibliografinë e informacionit të deklasifikuar.

3. Kopja e bibliografisë së informacionit të deklasifikuar t’i dërgohet zyrtarisht Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

4. Të bëhet publikimi i dokumenteve të deklasifikuara në faqen zyrtare të internetit të AIDSSH-së dhe në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KDZH-së
Gentiana Sula

VENDIM

Nr. 26, datë 20.8.2024

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar; në kreun I, të nenit 22, pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, të ndryshuar; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, të kryetarit të



Autoritetit, “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, i ndryshuar me urdhrin nr. 56, datë 23.3.2023, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, ‘Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 26, datë 20.8.2024, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Ersekë, kartelë model 2, nr. 2509, “Zemra”, në ngarkim të Q. M. Xh., me 1 (një) fletë. Kartela daton në vitet 1953–1986. Niveli i klasifikimit të Kartelës është “Sekret”.

2. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Ersekë, dosje personale dhe pune nr. 110 “Shkoza”, në ngarkim të M. (M.) H. O., me 131 (njëqind e tridhjetë e një) fletë në total. Dosja daton në vitet 1950–1978. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

3. Arkiva e Autoritetit, Fondi i Veçantë, dosje personale dhe pune nr. 6441, “Ostreni”, në ngarkim të F. Sh. Gj., me 158 (njëqind e pesëdhjetë e tetë) fletë në total. Dosja daton në vitet 1981–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

4. Arkiva e Autoritetit, Fondi i Veçantë, fashikull dhe dosje pune nr. 970, “Muratori”, në ngarkim të R. H. H., me 239 (dyqind e tridhjetë e nëntë) fletë në total. Dosja daton në vitet 1976–1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

5. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, dosje personale dhe pune nr. 3602, “Tigri”, në ngarkim M. F. L. (B.), me 69 (gjashtëdhjetë e nëntë) fletë në total. Dosja daton në vitet 1971–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

6. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, dosje personale dhe pune nr. 298, “Besniku”, në ngarkim të Rr. N. L., me 361 (treqind e gjashtëdhjetë e një) fletë në total. Dosja daton në vitet 1954–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

7. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Krujë, dosje personale nr. 2242, “Sharni”, në ngarkim të K. R. B., me 55 (pesëdhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1979–1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

8. Arkiva e Autoritetit, Fondi Ushtria, dosje personale dhe pune nr. 1272, “Shigjeta”, në ngarkim të Th. H. C., me 45 (dyzet e pesë) fletë në total. Dosja daton në vitet 1969–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

9. Arkiva e Autoritetit, Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje personale dhe pune nr. 9857, “Tanku”, në ngarkim të V. Z. Sh., me 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë në total. Dosja daton në vitet 1976–1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

10. Arkiva e Autoritetit, Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje personale dhe pune nr. 9428, “Fizika”, në ngarkim të A. Ll. S., me 13 (trembëdhjetë) fletë në total. Dosja daton në vitet 1976–1977. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

11. Arkiva e Autoritetit, Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, evidencë agjenturale operative e punëtorit operativ, me 284 (dyqind e tetëdhjetë e katër) fletë. Evidenca daton në vitin 1980. Niveli i klasifikimit të evidencës është “Sekret”.

12. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Vlorë, dosje personale dhe pune nr. 5455, “Sinjali”, në ngarkim të B. D. K., me 50 (pesëdhjetë) fletë në total. Dosja daton në vitet 1976–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

13. Arkiva e Autoritetit, Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje personale nr. 14579, “Gramozi”, në ngarkim të E. N. M. (Q.), me 30 (tridhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1987–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

14. Arkiva e Autoritetit, Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje personale nr. 11922, “Fonditori”, në ngarkim të M. S. L., me 47 (dyzet e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1987–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

15. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Dibër, dosje personale dhe pune nr. 4366, “Shpati”, në ngarkim të S. Q. K., me 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) fletë në total. Dosja daton në vitet 1986–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

16. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Vlorë, dosje personale dhe pune nr. 7299, “Sorkadhja” – “Delfini”, në ngarkim të B. A. Sh., me 364 (treqind e gjashtëdhjetë e katër) fletë në



total. Dosja daton në vitet 1986–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

17. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega IV, kartelë model 2, nr. 7508, “I Lumturi”, në ngarkim të L. M. J., me 1 (një) fletë. Kartela daton në vitet 1987–1991. Niveli i klasifikimit të kartelës është “Sekret”.

18. Arkiva e Autoritetit, Fondi Ushtria, dosje personale dhe pune nr. 13111, “Luani”, në ngarkim të B. K. K., me 100 (njëqind) fletë në total. Dosja daton në vitet 1983–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

19. Arkiva e Autoritetit, Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje personale dhe pune nr. 15823, “Thupra”, në ngarkim të P. K. L., me 30 (tridhjetë) fletë në total. Dosja daton në vitet 1989–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

20. Arkiva e Autoritetit, Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje personale dhe pune nr. 15219, “Studenti”, në ngarkim të V. L. R., me 73 (shtatëdhjetë e tre) fletë në total. Dosja daton në vitet 1988–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

21. Arkiva e Autoritetit, Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje personale dhe pune nr. 14318, “Shega”, në ngarkim të A. Q. B., me 60 (gjashtëdhjetë) fletë në total. Dosja daton në vitet 1986–1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

22. Arkiva e Autoritetit, Fondi nr. 141, Dega e Punëve të Brendshme Lushnjë, dosje personale nr. 3178, “Plepi”, në ngarkim të A. K. Ll., me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1983–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

23. Arkiva e Autoritetit, Fondi nr. 141, Dega e Punëve të Brendshme Lushnjë, kartelë model 2, nr. 4064, “Filmi”, në ngarkim të L. D. S., me 1 (një) fletë. Kartela daton në vitet 1987–1988. Niveli i klasifikimit të Kartelës është “Sekret”.

24. Arkiva e Autoritetit, Fondi nr. 141, Dega e Punëve të Brendshme Lushnjë, kartelë model 2, nr. 4141, “Llampa”, në ngarkim të Q. J. G., me 1 (një) fletë. Kartela daton në vitet 1987–1991. Niveli i klasifikimit të Kartelës është “Sekret”.

25. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Krujë, dosje personale dhe pune nr. 1868, “Pasqyra”, në ngarkim të M. F. Z., me 202 (dyqind e dy) fletë në total. Dosja daton në vitet

1970–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

26. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Korçë, dosje përpunimi nr. 4802, në ngarkim të Q. Sh. H., me 199 (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1960–1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

27. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Korçë, dosje personale dhe pune nr. 5174, “Drita”, në ngarkim të M. S. B., me 116 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë) fletë në total. Dosja daton në vitet 1975–1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

28. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Korçë, dosje personale dhe pune nr. 5153, “Studenti”, në ngarkim të V. I. K., me 86 (tetëdhjetë e gjashtë) fletë në total. Dosja daton në vitet 1971–1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

1. Arsyeja e deklasifikimit të dokumenteve të sipërcituara është:

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenin 22, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, si dhe në vendimin e Autoritetit nr. 31, datë 24.1.2023, pika 1 e dispozitivit.

2. Ngarkohet Sekretari i KDZH-së të bëjë evidentimet përkatëse në regjistër, të vendosë vulën përkatëse mbi dokumentet e deklasifikuara dhe të hartojë bibliografinë e informacionit të deklasifikuar.

3. Kopja e bibliografisë së informacionit të deklasifikuar t’i dërgohet zyrtarisht Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

4. Të bëhet publikimi i dokumenteve të deklasifikuara në faqen zyrtare të internetit të AIDSSH-së dhe në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KDZH-së
Gentiana Sula



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 128 lekë